



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:052259

Datë: 22.02.2019

Numri i dokumentit: 00231241

P.nr. 186/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. V. K. nga Sh., për shkak të veprës penale vjedhje e sherbimeve komunale ng neni 320 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP./II nr.897-3/18 të dt. 1204.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.21.02.2019, në prezencë të PSH Musli Gashi, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari M. K., nga i ati V., i lindur me dt. 11.07.1989, nga fshati Sh. ku dhe tani jeton, ka të mbaruar arsimin e mesëm, me profesion kuzhinjer, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i R. të Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

Se prej datës së pavërtetuar gjer me datën 12.02.2018 në fshatin Sh., Komuna e Suharekës, në shtepin e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar në atë menyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në menyrë direkte pa njëzor elektrik, duke krijuar lidhje direkte, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me çrast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 të KP.

Gjykata në kuptim të neneve 41,42,46,51,52,73, 74 si dhe nenit 320 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

**DËNIMIN ME KUSHT**

Të akuzuarit M. K. ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind Euro)**, dhe dënimin **me burg prej 3 muaj, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afat prej 1 viti**, nuk kryen veprë të njejtë apo te ngjajshme penale.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër të paushllit gjyqësor shumë prej 20€ dhe në emër të taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumën prej 30 €.

E dëmtuara KEDS në Prizren udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr.897-3/18 të dt. 12.04.2018, ka akuzuar akuzuarit M. V. K. nga fsh. Sh., për shkak të veprës penale të vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP,aktakuzën të cilën gjatë séances gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka perfaqësuar PSH Musli Gashi, i cili në tërsi ngel si në aktakuzë,me kërkesë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.21.02.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit,ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërsi është vërtetuar se prej datës së pavërtetuar gjer me datën 12.02.2018 në fshatin Sh., Komuna e Suharekës, në shtëpinë e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte pa njëzor elektrik, duke krijuar lidhje direkte, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me çrast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza, siq janë, procesverbali me nr. 231.... të dt. 12.02.2018, fatura DPZHP18..... e dt. 16.02.2018, si dhe fotodokumentacioni, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si provë materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis është bërë në mënyrë vullnetare i vetëdijshëm dhe në përputhje me nenin 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi denimet siqë është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasysh se i akuzuari ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës,pranimin në tërsi të veprës se kryer,është pënuar për veprën e kryer, familjar, kurse rrethanë posaqërisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muarr në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

Vendimi me të cilin është obliguar i akuzuari që të bëjë kompensimin e viktimës së krimit është marrë konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagraf 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË P.nr.186/18 të dt 21.02.2019**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.